

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nënit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Për: **UNIVERSITETI HAXHI ZEKA NË PEJË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **208/97400-26-6493-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e UHZ-së**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i Ankuesit

JAGUAR SECURITY SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.FAIK KONICA P.N

(Adresa)

PRIZREN

(Vendi)

20 000

(Kodi postar)

046 420 000

(Numri Telefonit)

NUK APLIKOHET

(Numri i Faks-it)

AMIR TERSHANI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@jaguarcom.al

(Adresa elektronike)

04.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues: Universiteti Haxhi Zeka - Pejë

Lënda: Shërbime

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

FPP fjalori kryesor: 66336200-6 Shërbimet e sigurimit të pronës

Vlera e parashikuar: 216,000.00€ (e madhe)

B05 Njoftimi për Kontratë: Data: 05.08.2026

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara:

Data: 01.09.2026

Afati për dorëzimin e tenderëve: Data: 07.09.2026

Kriteri për dhënien e kontratës: Oferta e përgjegjshme me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Jo, ankesa ka të bëjë kundër njoftimit për kontratë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

Jo, ankesa ka të bëjë kundër njoftimit për kontratë.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Konform dispozitës Neni 108/A të LPP-së në afatin e lejuar ligjor kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim konkretisht me datën 01.09.2026 nëpërmjet platformës së E-prokurimit, kurse AK-ja as nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, kurse refuzimin na ka kthyer poashtu me datë 01.09.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1 - Qëllimi,
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti,
Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi,
Neni 28 - Specifikimet teknike,
Neni 31 - Ekzekutimi i kontratave,
Neni 51 - Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes,
Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës,

2. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 25 - Kriteret e përzgjedhjes,
Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës,
Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve,
Neni 45 - Procedura e Hapur.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Duke kundërshtuar njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit nr. 208/97400-26-6493-2-1-1.

ANKESË

I. BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI I KËRKESËS

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, JAGUAR SECURITY SH.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar, paraqet këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj disa kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Kërkesa paraqitet me qëllim që dokumentacioni i tenderit të jetë i qartë, proporcional me objektin e kontratës dhe i zbatueshëm në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, duke ruajtur konkurrencën efektive dhe parimet e trajtimit të barabartë e të transparencës.

II. PRETENDIMET KRYESORE PËR SHKELJE

Pas shqyrtimit të kërkesave të Dosjes së Tenderit, vlerësojmë se disa prej kushteve të vendosura krijojnë paqartësi dhe kufizime që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e ofertës dhe në konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Në veçanti kundërshtohen: • përcaktimi i pagës bazë prej 500 EUR dhe kërkesa për përfshirjen e të gjitha obligimeve ligjore e kostove përcjellëse, pa një përputhje të qartë me buxhetin e parashikuar; • kushti që së paku 20 punëtorë të jenë të pajisur me karta të sigurimit me validitet të mbetur prej së paku një viti; • kërkesa që operatori ekonomik të ketë njësi të hapur në rajonin e Pejës ose Gjakovës para njoftimit për kontratë.

III. PAGAT, ANALIZA FINANCIARE DHE PËRPUTHSHMËRIA ME BUXHETIN

Dosja e Tenderit kërkon që analiza financiare të ndërtohet mbi pagën bazë prej 500 EUR dhe, njëkohësisht, të përfshijë pagesat shtesë për ndërrimet e natës, festat shtetërore, përvojën e punës, pushimet vjetore, kontributet pensionale, fitimin e operatorit ekonomik, TVSH-në dhe totalin e ofertës.

Në një situatë të tillë, fondi i parashikuar duhet të jetë realisht i harmonizuar me të gjitha kostot që Autoriteti Kontraktues kërkon të përfshihen në çmim. Sipas vlerësimit tonë, dokumentacioni nuk jep siguri të mjaftueshme se buxheti i planifikuar mbulon në tërësi këto detyrime. Po ashtu, nuk është përcaktuar në mënyrë të prerë nëse shuma prej 500

EUR duhet të trajtohet si pagë neto apo bruto. Kjo paqartësi është materiale, sepse ndikon drejtpërdrejt në kalkulimin e kostos dhe mund të sjellë qasje të ndryshme nga operatorët ekonomikë, e rrjedhimisht edhe trajtim jo të njëtrajtshëm gjatë vlerësimit. Për këto arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues të sqarojë natyrën neto/bruto të pagës, të rishikojë kalkulimin e buxhetit dhe, nëse rezulton e nevojshme, të bëjë amendamentimin përkatës në mënyrë që fondi i parashikuar të jetë i mjaftueshëm për realizimin e të gjitha detyrimeve të kërkuara.

IV. KUSHTI PËR 20 PUNËTORË ME KARTA SIGURIMI ME VALIDITET NJËVJEÇAR

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë së paku 20 punëtorë me karta sigurimi të lëshuara nga MPB-ja dhe me validitet të mbetur prej së paku një viti, sipas vlerësimit tonë, shkon përtej asaj që është e nevojshme për të dëshmuar kapacitetin real për ekzekutimin e kontratës. Një operator mund të ketë personel të licencuar, profesionalisht të aftë dhe të gatshëm për angazhim, ndërsa afati i mbetur i dokumentacionit individual mund të jetë më i shkurtër për arsye objektive. Për më tepër, kartat e punëtorëve mund të lidhen me angazhime, pozicione ose institucione të caktuara dhe nuk duhet të trajtohen automatikisht si kriter absolut i aftësisë së operatorit për realizimin e kontratës. Për pasojë, kushti për validitet të detyrueshëm prej së paku një viti për të gjithë 20 punëtorët mund të krijojë barrierë të panevojshme ndaj operatorëve që, në aspektin profesional dhe ligjor, janë të aftë për të ofruar shërbimin. Kërkojmë që ky kusht të hiqet ose të riformulohet, duke lejuar që operatori ekonomik të dëshmojë disponueshmërinë e personelit të kualifikuar dhe obligimin që, para fillimit të ekzekutimit të kontratës, të gjithë punëtorët e angazhuar të posedojnë dokumentacionin dhe licencat valide sipas legjislacionit në fuqi.

V. KËRKESA PËR NJËSI TË HAPUR NË RAJONIN E PEJËS OSE GJAKOVËS

Dosja e Tenderit parashikon që operatori ekonomik të ketë njësi të hapur në rajonin e Pejës ose Gjakovës. JAGUAR SECURITY SH.P.K. vlerëson se lidhja e kualifikimit të operatorit me një vendndodhje të caktuar gjeografike, pa u dëshmuar domosdoshmëria objektive e saj për realizimin e kontratës, krijon kufizim territorial të konkurrencës. Neni 7 i LPP-së kërkon trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë dhe ndalon vendosjen e kërkesave që, pa arsyetim të ligjshëm dhe proporcional, reduktojnë konkurrencën ose favorizojnë operatorë të caktuar. Një operator ekonomik mund të posedojë kapacitetet e nevojshme teknike, profesionale, njerëzore dhe organizative për ekzekutimin e kontratës, pavarësisht se selia apo njësia e tij ndodhet në një rajon tjetër të Republikës së Kosovës. Prandaj, vetë vendndodhja paraprake nuk duhet të shndërrohet në pengesë për pjesëmarrje kur aftësia për realizimin e shërbimit mund të dëshmohet me mjete më proporcionale. Kërkojmë që ky kriter të hiqet ose të ndryshohet në mënyrë që, nëse ekziston nevojë reale për prani operative në rajonin përkatës, operatorit të përzgjedhur t'i kërkohet sigurimi i kësaj pranie para fillimit të ekzekutimit të kontratës, pa e kushtëzuar pjesëmarrjen me ekzistencën paraprake të njësisë.

VI. INTERESI DHE DËMI I OPERATORIT EKONOMIK

Kushtet e kundërshtuara ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e JAGUAR SECURITY SH.P.K. për të përgatitur ofertë të saktë dhe për të konkurruar në kushte të barabarta. Paqartësia financiare, kërkesa për validitetin e kartave dhe kushti territorial mund të kufizojnë pjesëmarrjen edhe të operatorëve që posedojnë kapacitete reale për realizimin e kontratës. Si operator ekonomik që ushtron veprimtari në fushën e sigurimit fizik, kemi interes të drejtpërdrejtë dhe legjitim që kriteret e tenderit të jenë të qarta, të arsyeshme, proporcionale dhe të lidhura me nevojat reale të kontratës.

VII. KËRKESAT PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, JAGUAR SECURITY SH.P.K. kërkon nga Autoriteti Kontraktues që: • ta aprovojë këtë Kërkesë për Rishqyrtim si të bazuar; • ta rishikojë buxhetin e parashikuar duke përfshirë realisht të gjitha detyrimet dhe shpenzimet e kërkuara në Dosjen e Tenderit; • ta sqarojë shprehimisht nëse paga bazë prej 500 EUR është neto apo bruto; • ta amendamentojë Dosjen e Tenderit në pjesën financiare, nëse kjo është e nevojshme për harmonizimin e kërkesave me fondin e parashikuar; • ta heqë ose riformulojë kushtin për 20 punëtorë me karta siguri me validitet të mbetur së paku një vit; • ta heqë ose riformulojë kërkesën për njësi të hapur paraprakisht në rajonin e Pejës ose Gjakovës, duke e zëvendësuar me një kërkesë proporcionale që lidhet me aftësinë reale për realizimin e kontratës; • nëse ndonjë prej kushteve të kundërshtuara mbahet në fuqi, të jepet arsyetim i plotë, konkret dhe i mbështetur lidhur me domosdoshmërinë, proporcionalitetin dhe lidhjen e tij me objektin e kontratës.

Kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të ndërmarrë veprimet korrigjuese të nevojshme dhe të sigurojë vazhdimin e procedurës mbi bazën e kushteve të qarta, të barabarta, transparente dhe konkurruese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit na janë krijuar shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë aktivitet të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat mund të ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.